

# PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL NË SHQIPËRI

Thirrje për Aplikime për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

Titulli i projektit:	Përmirësimi i ofertës turistike dhe rritja e sezonalitetit ne fshatrat Lepushe dhe Vermosh
Vendndodhja(et) e projektit:	Rajoni 1, Bashkia Malesi e Madhe, fshatrat Lëpushë & Vermosh,
Emri i aplikantit kryesor	Bashkia Malesi e Madhe
Emri i bashkë-aplikantit <sup>1</sup>	
Emri i partnerit në projekt <sup>2</sup>	Assist Albania

Aktoret kyc te këtij projekti jane:

**Bashkia e Malesi e Madhe** - Bashkia përveç kryerjes se detyrave te saj funksionale ne territor, luan nje rol te rëndësishëm per planifikimin dhe realizimin e ndërhyrjeve specifike me fokus turizmin, organizimin e eventeve dhe promovimin e zonës, si dhe nëpërmjet Qendres per Zhvillimin e Turizmit ne Vermosh kontribuon per informimin e turisteve, permiresimn e shërbimeve qe ofrojnë banoret dhe operatorët si dhe organizimin e komunitetit. Roli i Njesise Administrative Klemend eshte po aq i rendesishem.

**Banoret e fshatrave** - Banoret do te luajne nje rol te rëndësishëm ne kete projekt duke qene pjesëmarrës ne aktivitetet e parashikuara, por edhe duke u bere pjese aktive e proceseve te vendimmarrjes dhe organizimit.

**Operatorët turistike** - Operatorët turistike janë ata qe organizojnë grupet e turisteve qe frekuentojnë zonën dhe qe sjellin përvojën e tyre ne krijimin e aktiviteve turistike. Ata përveçse gjenerojne ekonomi lokale nëpërmjet bashkëpunimit me bujtinat dhe restorantet ne zone, bëjnë edhe promovimin e atraksioneve dhe te natyrës ne nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

**OJF**- këto organizata kontribuojnë ne organizimin e banoreve, advokimin e interesave te grupeve specifike, si dhe formimin dhe ngritjen e kapaciteteve.

## a- Logjika e ndërhyrjes

Ndërhyrja synon te pasuroje ofertën turistike aktuale ne fshatrat Lepushe dhe Vermosh nëpërmjet:

- shtimit te itinerareve te reja ne natyre duke shtuar përveç shtigjeve per ecje edhe dy produkte te reja si shtigjet per biçikleta dhe shtigje per motor malor me 4 rrota;
- krijimit te nje atraksioni te ri dimëror ne zonën e Lëpushës duke përmirësuar nje piste natyrore per rrëshqitje dhe duke ngritur nje linje lëvizje vertikale per transportin e turisteve;
- krijimit te nje kalendari eventesh gjithëvjeter ku përfshihen festat dhe aktivitetet ekzistuese si dhe aktivite te reja te propozuara; organizimin e dy eventeve specifike;
- përmirësimit te mjeteve te informimit per turistët duke kataloguar atraksionet turistike dhe duke prodhuar harta dhe leflea te informues qe do te shpërndahen neper bujtina si dhe online;

<sup>1</sup> Emri i çdo bashkë-aplikanti të shkruhet në rresht më vete.

<sup>2</sup> Emri i çdo partneri projekti të shkruhet në rresht më vete.

- organizimit të aktoreve kyç në një partneritet të përbashkët që do të kontribuojë në menaxhimin e destinacionit në formën e një strukture të qëndrueshme të atashuar tek Qendra e Zhvillimit të Turizmit;
- Promovimit të destinacionit përmes formave të ndryshme, si mediat sociale, etj

### Produktet

Produktet kryesore që parashikohet të dalin nga ky projekt janë si më poshtë:

- 2 shtigje për ecjen të pastruara, dhe të hedhura në mënyrë digitale në hartë;
- 1 circuit për lëvizjen me biçikleta i hedhur në mënyrë digitale në hartë dhe 5 biçikleta të blera në dispozicion të turistëve në QZHT Vermosh (Bicikleta mountain bike 28)
- 1 circuit për lëvizjen me motor malor i hedhur në mënyrë digitale në hartë dhe 2 motore të blera në dispozicion të turistëve në QZHT Vermosh; (Motor ATV me shpejtësi maksimale 80 km/ ore, me kapacitet mbajtës 200 kg)
- Hartë me atraksionet turistike në fshatrat Vermosh dhe Lepushe përfshirë itineraret e reja e shtypur dhe online;
- 1 piste e re për rrëshqitje dhe linja vertikale për lëvizjen e turistëve në Lepushe e instaluar dhe funksionale; (100 metra teleferik, me shpejtësi max 2,3 m/s, e vendosur në lartësinë prej 1359,8- 1398, 6 m)
- Struktura e partneritetit për menaxhimin e destinacionit e mbledhur dhe aktive në hartimin e strategjisë afatmesme të turizmit ( Partneritet Publik- Privat, me një bord drejtues të përbërë prej të paktën 5 anëtarëve të cilët përfaqësojnë drejtime të ndryshme të sektorit të turizmit)
- 1 strategji zhvillimi afatmesme për turizmin malor
- 2 evente lokale të zhvilluara të mbështetura dhe promovuara;
- Fushata promovuese online në mediat sociale të bashkisë dhe të fshatrave;

### Rezultatet e pritshme

- Zgjatjen e sezonit turistik me të paktën 4 fundjava deri në periudhën Nentor 2022 (vendosja e teleferikut 100 metra, do lehtësojë aktivitetet turistike, forcojë sigurinë për jetën e vizitorëve e do shtojë numrin e të interesuarve përgjatë sezonit dimëror).
- Rritja e numrit të turistëve me 10% (Duke vlerësuar rreth 15.000 vizitorët ditorë dhe turistë deri në fund Nentorit 2022).
- Rritja e punësimit në sektorin e turizmit me 10% (Impakti i shtimit të turistëve, shoqërohet me krijimin e vendeve të punës: minimalisht në fund të Nentorit 2022 numri i të punësuarve rrishtaz vlerësohet 20-30 persona)
- Rritja koordinimit dhe bashkëpunimit mes aktoreve kyç;
- Rritje e frymës komunitare dhe nderveprimit mes banorëve; Përfshirja e komunitetit në partneritet, krijimin e senjalistikës, bashkëpunimin dhe rritëzimin e komunitetit).

### Llojet e aktiviteteve dhe afati kohor.

1. Permiresimi i shtigjeve ekzistuese për ecjen nëpërmjet pastrimit dhe shënjimit të shtigjeve ekzistuese si dhe hedhja në mënyrë digitale në hartë e dy shtigjeve të reja rrotull fshatrave Lepushe dhe Vermosh; Ky permiresim do të realizohet përmes angazhimit të partnereve në projekt, grupet e vullnetareve dhe komunitetit të zonës. Përmes këtij bashkëpunimi do të krijohet një sinergji midis paleve në projekt.
2. Promovimi i një circuiti të kalueshëm për biçikleta, dhe hedhjen në mënyrë digitale në hartë; Nisur nga fakti se shumë prej vizitorëve dhe turistëve të zonës kanë shprehur dëshirën që të shfrytëzojnë dhe këto mjet levizës ekologjikisht miqësor për arritjen e atraksioneve të ndryshme natyrore, krijimi i këtij circuiti do të jetë një vlerë e shtuar në zonë.
3. Promovimi i një circuiti për motorë malor me katër rrota, dhe hedhjen në mënyrë digitale në hartë; Në rastin e këtyre mjeteve levizëse, është marrë në konsideratë fakti se kjo zonë frekuentohet nga turistë motocikliste, të cilët pelqejnë aventurën, emocionet sportive, eksplorimin.
4. Blerja e logjistikes për lëvizjen në circuitet e mësipërme dhe kalimi i saj në administrim të Qendres për Zhvillimin e Turizmit; Blerja e këtyre pajisjeve do të shërbente edhe si një mundësi e mirë për ngritje fondesh, përmes përdorimit të këtyre

- mjeteve. Te ardhurat e krijuara mund te mbeshtetin aktivitetet e strukture se partneritetit.
5. Katalogimi i te gjitha atraksioneve turistike ekzistuese dhe te reja ne territorin e fshatrave Lepushe dhe Vermosh; Krijimi i nje baze te dhenash do te jete nje mjet i nevojshem per zbatimin e nje fushate promocioni te suksesshme dhe rritjen e interesimit te turisteve, operatoreve turistike dhe aktoreve te tjere.
  6. Krijimi nje harte digitale dhe vënia ne dispozicion te turisteve online dhe hardcopy ne bujtinat e zonës; Krijimi i kesaj harte do te rriste ne menyre te rendesishme aksesin ne zone, permes nje informacioni te sakte dhe mjaft lehte te shfrytezueshem.
  7. Pershtatja per rrëshqitje e nje piste natyrore ne zonën e Lepushes, instalimi i nje linje vertikale te transportit te turisteve dhe kalimi i saj ne administrim te QZHT Vermosh; Kjo piste do te perfaqesoje nje risi ne sherbimet e ofruara ne zone. Ne te gjithë zonen nuk ka investime te tilla, qe bejne te mundur shfrytezimin e bukurive natyrore te zones gjate periudhes se dimrit.
  8. Hartimi i nje strategjie afatmesme te zhvillimit te turizmit dhe nje roadmap per ngritjen e nje strukture partneriteti mes aktoreve ky per menaxhimin e destinacionit turistik; Kjo strategji do te sherbeje si nje dokument orientues per bashkine ne fushen e turizmit, duke mundesuar orientimin e politikave, burimeve njerezore dhe financiare ne menyre me efektive.
  9. Ngritja e strukturës se partneritetit per menaxhimin e destinacionit dhe zhvillimi i takimeve koordinuese ne ambientet e QZHT Vermosh; Kjo strukture do te perfaqesoje nje model te ri bashkepunimi te aktoreve lokale, permes angazhimit dhe kontributit ne menyre te drejteperdrejte. Kjo do te sjelle nje vizion te ri mbi menaxhimin e destinacionit, si rezultat i nje partneriteti te te gjithë aktoreve ne zone.
  10. Krijimi i ne kalendari eventesh me aktivitetet egzistuese apo te reja per Njesine Administrative Kelmend dhe publikimi i saj ne mediat sociale; Kalendari i ri do te sherbeje si nje mundesi per te promovuar dhe marketuar me mire potencialin turistik te zones se Kelmendit, permes angazhimit te aktoreve ne zone dhe me gjere.
  11. Zhvillimi dhe mbeshtetja e dy eventeve lokale me fokus ne prodhimin lokal ushqimor dhe artizanal dhe traditën dhe folklorin. Mbeshtetja e ketyre dy eventeve do te synoje perfshirjen e komunitetit ne keto aktivite, permes promovimit te produkteve autentike te zones qofte ne kulinari apo artizanat, me qellim ruajtjen dhe konservimin e vlerave tradicionale dhe historike te zones.
  12. Ndermarrja e nje fushate promovuese ne mediat sociale; Kjo fushate do te sherbeje si nje mjet efektiv komunikimi dhe promovimi duke shenjestruar perdoruesit e mediave sociale.

Afati kohor per realizimin e aktivitetit do te jete 10 muaj.

### **2.1 Përshkrimi i projektit** *(jo më shumë se 2 faqe (përfshirë Tabelën 1) me font Arial 11, hapësirë teke mes rreshtave)*

Zona e Kelmendit perfaqeson nje pjese te rendesishme te Parkut Kombetar te Alpeve shiptare. Rajoni i alpeve përbëhet kryesisht nga gurët gëlqerorë, por ka edhe depozita terrigjene dhe magmatike. Në këtë ndërtim gjeologjik përfshihen minerale të tilla si mineralet e kromit, bakrit, boksitit dhe kuarcitit.

Kuadri i burimeve natyrore të alpeve gjithashtu përfshin bimët, pyjet dhe faunën si elementet e nevojshme plotësuese të një mjedisi turistik alpin. Kjo zonë malore dallon sidomos për pyjet e kodrave, pishave, shkurreve dhe kullotave alpine.

Karakteristika më tipike e ambientit të zones se Kelmendit është pasqyrimi i mrekullueshëm i botës alpine me botën autentike njerezore të fshatrave te zonës, të cilat janë lidhur ndër shekuj me zakonet dhe natyrën e saj.

Zona karakterizohet edhe nga tradita artizanale, veçanërisht ajo e përpunimit të drurit dhe leshit. Produktet nga përpunimi i drurit në stolitë shtëpiake janë të njohura në të gjithë zonën e përtej. Zona përmban monumente historike dhe prova që dëshmojnë qytetërime që nga Epoka e Hekurit..

Kelmendi dallon gjithashtu për morfologjinë malore të terrenit dhe pozicionin strategjik gjeografik. Pothuajse të gjitha fshatrat në këtë rajon kanë të njëjtat karakteristika për sa i përket morfologjisë dhe karakterit territorial. Një morfologji e këtij lloji ka rezultuar në akses të dobët dhe rrjedhimisht në krijimin e qendrave rurale. Ky element paraqet në të njëjten kohë karakteristika pozitive që përbëjnë potencial për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit.

Bujqësia dhe blegtoaria janë burimet kryesore të të ardhurave dhe aktivitetit ekonomik të zonës. Tregtia është veçanërisht e zhvilluar në drejtim të shitjes së produkteve blegtorale, zejtarisë dhe punishteve të përpunimit të drurit

Të ardhurat e banorëve në zonen e Kelmendit konsiderohen si më të ulëta në të gjithë Shqipërinë dhe shkalla e papunësisë arrin nivelin e 48% të popullsisë në moshë pune. Për më tepër sektori bujqësor është sektori kryesor i punësimit në njësinë administrative në Kelmend, ku më shumë se 56% e popullsisë aktive janë të punësuar në këtë sektor dhe vetëm 37% në sektorin e shërbimeve (sektori i shërbimeve dominohet nga punësimi në qeverine lokale dhe qendrore).

Duke pasur parasysh se sektori i bujqësisë nuk është zhvilluar teknikisht dhe teknologjikisht, se bujqësia përfaqëson një nga aktivitetet kryesore ekonomike të njësisë familjare, dhe se prodhimi bujqësor kryesisht shërben për mbijetesën e fermerëve, atëherë nevojiten nderhyrje në përmirësimin e tregut të punës.

Edhe nëse 66% e popullsisë është në moshë pune, që do të thotë një forcë e mirë për zhvillimin e mundshëm të ardhshëm, kjo popullsi nuk përfiton arsimim apo kualifikim të mirë (74% kanë arsim fillor, 15% kanë arsim të mesëm, 7% kanë arsim universitar). Në këtë kontekst, formimi, edukimi dhe kualifikimi i popullsisë vendase është një domosdoshmëri për të përmirësuar aktivitetet ekonomike në zonë.

Fshati Lopushe dhe i Vermoshit ndodhen në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare, me peizazhe tërheqëse natyror, lloje të ndryshme të monumenteve natyrore, traditë në prodhimin bujqësor dhe arkitekturë karakteristike vendase. Edhe pse bujqësia është një nga aktivitetet kryesore ekonomike të zonës, sektori turistik po bëhet një element i rëndësishëm për ekonominë vendase.

Aktualisht në këtë zonë ka 16 struktura akomodimi turistik, ndër të cilat janë 14 bujtina dhe 2 hotele, me një kapacitet total prej 197 shtretërisht (139 shtretër në bujtina dhe 58 shtretër në hotele). Kjo strukturë ka pasur kryesisht funksionim sezonal deri në vitin 2017 (duke punuar vetëm gjatë muajve maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator).

Gjatë vitit 2020-2021 kjo zonë po frekuentohet dhe në periudhën e stinës së dimrit e kërkesat janë gjithmposhtë në rritje.

Me përfundimin e ndërtimit të rrugës Hani i Hotit - Vermosh në shtator 2016, strukturave të akomodimit turistik u është dashur të përballen me një kërkesë të madhe që nga marsi i vitit 2017. Për më tepër, kapaciteti aktual i akomodimit turistik nuk mund të përballojë numrin e madh të turistëve që vijnë për fundjavë. Në këtë kontekst zona shfaq mungesa në organizim dhe orientim turistik.

Problemet kryesore të sistemit të akomodimit turistik janë renditur më poshtë:

- Sezonalitet i lartë
- Kohë e shkurtër e qëndrimit
- Mungesa e standardeve të akomodimit;
- Mungesa e cilësisë së shërbimit;
- Fluksi i çrregullt turistik;
- Mungesa e shërbimeve turistike (kryesisht të kufizuara në bar-restorante, pa marrë parasysh aktivitetet rekreative në rast të motit të keq);
- Ofrohen vetëm disa aktivitete në natyrë (ecje, hiking, alpinizëm, vizita në monumentet natyrore dhe shpellat);
- Mungesa e veprimtarive gjatë sezonit dimëror

Në zonë ka vetëm disa restorante dhe bare, ku shumica e tyre janë përqendruar në produkte vendase dhe gastronomi. Megjithatë, fluksi në rritje i vizitorëve rrezikon të krijojë një mungesë të produkteve vendase.

Shtigjet natyrore janë aktivitetet kryesore të kryera nga vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë, rrjedhimisht udhërrëfyesit vendas po bëhen gjithnjë e më të kërkuar.

Nisur nga përshkrimi i mesiperm i situatës në zonën e Kelmendit, bashkia Malesi e Madhe ka vlerësuar si të nevojshme zbatimin e këtij projekti me qëllim *“Nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal nëpërmjet sektorit të turizmit si dhe rritjen e angazhimit të komunitet lokal në fshatrat Lepushe dhe Vermosh në përcaktimin, zhvillimin dhe bashkëmenaxhimin e destinacionit turistik.*

Ky objektivi kryesor do të realizohet nëpërmjet disa objektivave specifike:

*1- Forcimi dhe ngritja e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për turizmin në Bashkinë Malesi e Madhe;*

Angazhimi dhe menaxhimi i projekteve në fushën e turizmit është shndërruar në një kërkesë dhe domosdoshmëri për stafin e Bashkisë Malesi e Madhe. Rritja e interesimit të turistëve për zonën e Kelmendit e vendos bashkinë përballë sfidave të reja për të ardhmen dhe përgatitjen drejt një zhvillimi të qëndrueshëm turistik. Kjo kërkon njëkohësisht dhe forcimin e kapaciteteve menaxhuese në strukturat e saj, përmes zbatimit të projekteve të tilla zhvillimore.

Një rol të rëndësishëm në këtë projekt, për arritjen e këtij objekti do të jetë dhe mbështetja me ekspertizë nga aktore të fushës së turizmit, në mënyrë që të njihen me praktikën dhe modelet më të suksesshme të rajonit dhe më gjërë. Për këtë arsye personat kyç në bashki do të jenë pjesë integrale e hartimit të strategjisë afatmesme të turizmit. Ky objektivi do të realizohet përmes aktivitetit 1.1 dhe 1.2

*2- Përmirësimi dhe diversifikimi i ofertës turistike ekzistuese në fshatrat Lëpushë dhe Vermosh;*

Bashkia Malesi e Madhe e ka vendosur këtë objektivi, si rezultat i identifikimit të potencialit që shfaq kjo zonë, përmes rritjes së numrit të aktivitetëve rekreacionale dhe promovuese. Për shkak të infrastrukturës natyrore turistët kanë mundësi të shijojnë atraksionet turistike të zonës të pashfrytëzuara më parë edhe jashtë sezonit të zakonshëm turistik. Realizimi i këtij objekti do të arrihet përmes aktivitetëve 2.1.1 – 2.1.5.

*3- Zgjerimi i sezonit turistik duke përfshirë dhe aktivitetet dimerore*

Ky objektivi është parashikuar të përmbushet përmes ofrimit të një informacioni sa më të nevojshëm, të plotë dhe profesional për turistët. Në këtë mënyrë do të rriten mundësitë që shërbimet e ofruara në këtë zonë të përshkruhen edhe me karakteristikën klimatike dhe meteorologjike të zonës, në mënyrë që të jenë interesante dhe tërheqëse për vizitorët.

Përgatitja e një harte digjitale dhe të printuar turistët do të krijojnë një panoramë më të qartë mbi atraksionet dhe shërbimet e ofruara edhe gjatë sezonit të dimrit. Ky objektivi do të realizohet nga aktiviteti 3.1.1

*4- Nxitja e ndërveprimit social nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes së banorëve në një formë partneriteti me bashkinë dhe operatore turistike për menaxhimin e destinacionit;*

Projekti vlerëson mjaft të rëndësishëm rolin që duhet të luajë komuniteti i zonës, si përfituesit direkt të tij. Për të forcuar këtë rol është parashikuar ngritja e një strukture partneriteti midis aktoreve në zonë me qëllim vlerësimin e kontributeve, angazhimit dhe bashkëpunimit të secilit prej aktoreve. Ky proces do të realizohet përmes takimeve publike dhe diskutimeve në komunitet. Komuniteti do të jetë pjesë e vendimmarrjes e cila lidhet me menaxhimin e destinacionit turistik në zonën e Kelmendit.

Për arritjen e këtij objekti janë parashikuar një sërë aktivitetesh 4.1.1 – 4.1.6

*5- Zgjerimi i tregut nëpërmjet promovimit të ofertës turistike dhe produkteve lokale*

Bashkia Malesi e Madhe ka identifikuar nevojën e një fushate promovimi në median online, duke e konsideruar këtë model promovimi si bashkëkohor dhe të suksesshëm. Përmes kësaj fushate promovimi do të synohet që të kryhet edhe një marketing sa më i mirë mbi shërbimet dhe produktet e zonës së Kelmendit. Kjo fushatë do të përfshijë dhe të rinjtë e zonës me qëllim përfshirjen e tyre në procesin e aktivitetëve turistike duke synuar qëndrueshmërinë dhe në punësimin në të ardhmen.

